



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:016337

Datë: 23.02.2023

Numri i dokumentit: 04009806

P.nr. 08/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit - praktikantit Dardan Ibrahim, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit A. S. me vendbanim në rr.”I.H.” nr.4, V. për shkak të veprave penale *Sulmi* nga neni 184 par.3, nën par.3.1 dhe *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1803/2022 të datë 18.01.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar të datës 14.02.2023, në praninë e të dëmtuares dhe të pandehurit në të njëjtën ditë shpalli, ndërsa me datë 16.02.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I PANDEHURI: A. S. nga i ati F. dhe e ëma T. e gjinisë Z. i lindur me ... në fshatin T. komuna V. me vendbanim në rr.”I. H.” nr..., V. me numër personal ... ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, me profesion elektrikist, i papunë, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: I. Me datë 28.08.2022, rreth orës 23:55, në V. në rr.”I. H.” saktësisht në shtëpinë e tyre përdorë forcën ndaj të dëmtuares – viktimë e ndjeshme B. Rr. si pasojë e mosmarrëveshjes, të cilën e kishin pasur në mes veti për faktin rreth përgatitjes së ushqimit, në atë rast i pandehuri në prani të mysafirëve familjarëve të të dëmtuarës e godet dy herë me shuplakë në fytyrë dhe në qafë, dhe pse ka qenë në dijeni se e njëjta është në muajin e tretë të shtatëzanisë, në atë moment duke e parë këtë situatë ndërhyjnë motra e saj për t’i ndarë, veprime këto të cilat kanë shkaktuar ndjenjën e frikës, pasigurisë si dhe rrezikshmërisë personale, si dhe të fëmijës në pritje;

Me këtë ka kryer veprën penale *Sulmi* nga neni 184 par.3, nën par.3.1 të KPRK-së.

II. Më datën, kohën, vendin si në pikën I të dispozitivit, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuares L.Rr. si pasojë e mosmarrëveshjes në mes të pandehurit dhe bashkëshortes së tij B. Rr. ashtu që deri sa e dëmtuara ishte mysafir tek e motra e saj dhe me të parë të pandehurin duke e goditur motrën e saj ndërhyjnë për t’i ndarë në atë moment i njëjti e godet shuplak në fytyrë dhe në qafë, duke e rrëzuar kështu në tokë dhe si pasojë e kësaj e njëjta pëson lëndime trupore dhe atë ndrydhje në indet e buta të kokës dhe qafës, gërvishtje dhe gjakmbledhje nën lëkurore në regjionin e kyçit të dorës së djathtë, si dhe ndrydhje në regjionin e shpinës, dëmtime këto të natyrës së lehtë trupore me pasoja të pëkohshme për shëndetin;

Me këtë ka kryer veprën penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së,

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 76, 184 par.3 nën par.3.1 dhe nenit 185 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 453, 463 të KPP-së i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I. Për veprën penale si në pikën I të aktakuzës gjykata te pandehurit i vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, si dhe për veprën penale si në pikën II të aktakuzës i vërteton dënimin me burg prej gjashtë muaj.
- II. Ne kuptim te dispozitave te nenit 76 te KPRK-së gjykata te pandehurit i vërteton dënimin unik me burg ne kohëzgjatje prej 10 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vitësh, në qoftë i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale:
- III. DETYROHET i pandehuri qe në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të ekspertizës mjekoligjore shumën prej njëzetë (20) euro dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzetë (20) euro. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën 1803/2022 të datë 18.01.2023, kundër të pandehurit A. S. me vendbanim në rr."I. H." nr... V. për shkak të veprave penale *Sulmi* nga neni 184 par.3, nën par.3.1, dhe *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me datë 14.02.2023, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Zef Prendrecaj, i pandehuri personalisht, të dëmtuarat B. Rr. dhe L.Rr. si dhe mbrojtësi i viktimave Muhamet Përvetica.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 14.02.2023, gjyqtari i vetëm gjykues pasi e informoj të pandehurin me të drejtat e tij dhe pasi u bind se i njëjti i ka kuptuar ato, ka ftuar prokurorin e shtetit që të lexoj aktakuzën. Pas leximit të aktakuzës dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se e kupton aktakuzën e lexuar dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë për veprën që i vihet në barrë sipas aktakuzës, ku i njëjti ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës.

Pas pranimit të fajësisë, gjykata paraprakisht e ka njoftuar të pandehurin lidhur me benefitet e pranimit të fajësisë, ndërsa ia ka tërhequr vërejtjen edhe lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që të njëjtin e ka njoftuar për dënimet e parapara për veprën penale *Sulmi* nga neni 184 par.3, nën par.3.1 dhe veprës penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjithashtu gjykata e ka njoftuar të pandehurin se me pranimin e fajësisë nuk do të mund të kundërshtojë provat apo të parashtoj provat në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojë vendimin për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarin mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese.

I pandehuri edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, ka deklaruar se dëshiron ta pranojë fajësinë dhe ka shtuar se e vetmja gjë që do është që të jetë mirë me familjen e tij, ta ruaj familjen e tij, dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, me gruan tani i ka raportet shumë të mira, ashtu edhe me motrën e gruas e cila banon në fshatin B. por që shkon shpesh, që dy javë është tek shtëpia e tyre, pra tek motra e vet përkatësisht gruaja e tij, kanë raporte shumë të mira, por që ka ndodhur ajo se çfarë ka ndodhur, për çka është përdur, ju ka kërkuar falje edhe gruas edhe motrës së gruas, dhe kërkim falje është pranuar, i është falur gabimi që ka bërë në raport me të dëmtuarat. Gjithashtu shton se tani e kanë një fëmijë të përbashkët dy muajsh, ka qenë një moment që nuk ka qenë në gjendje që ta kontrollojë vetën për çka është përdur por që e çmon shumë fëmijën e përbashkët që e kanë me të dëmtuarën dhe kujdesen bashkë për të.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit ka deklaruar se me qenë se i pandehuri me vullnetin e tij të lirë në prezencë të dy të dëmtuarave respektivisht bashkëshortes dhe motrës së saj ka pranuar fajësinë dhe për shkak se pranimi i fajësisë nga ana e tij ka mbështetje të plotë në provat materiale të cilat janë të bashkangjitur me aktakuzën, si prokuror i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë dhe i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovoj.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, mbrojtësi i viktimave deklarohet se e mbështetin deklaratën e prokurorit të shtetit e gjithashtu e njoftojnë gjykatën se pala e dëmtuar B. Rr. në këtë çështje nuk i bashkohet ndjekjes penale dhe se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike me qenë se tani më kanë rregulluar raportet me të pandehurin dhe jetojnë në një ekonomi të përbashkët familjare. Gjithashtu gjykatës i propozojnë që me rastin e shqiptimit të sanksionit përveç pranimit të fajësisë të marr parasysh se sanksioni i ashpër ndikon edhe në palën e dëmtuar si bashkëshorte, sidomos në përkujdesjen ndaj fëmijës së tyre.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri e dëmtuara B. Rr.ka deklaruar se ata kurrë probleme nuk kanë pasur përveç këtij rasti, edhe pas këtij rasti duke aluduar në të pandehurin, ka kërkuar falje dhe është përdur, dhe tani kujdeset shumë dhe i rri gati si gruas ashtu edhe djalit të posalindur. Gjithashtu shton se nuk ka kurrfarë kërkesë pasurore juridike.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri e dëmtuara L. Rr. deklaron se ajo shpeshherë shkon në vizitë te motra dhe tash herën e fundit ka një javë që është te motra dhe raportet e tyre me A.janë të mira, është i sjellshëm, kujdeset për motrën dhe për familjen, ndërsa kërkesë pasurore nuk ka, e gjithashtu dëshiron që gjykata të ia falë, pasi që ajo ja ka falur.

Provat e vlerësuara nga gjykata

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 248 në lidhje me nenin 326 të KPP-së, dhe ka konkluduar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës.

Gjykata ka pranuar deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-BD-808, i datës 29.08.2022, raporti ditor i dhunës familjare, me numër të rastit 2022-BD-808, i datës 29.08.2022, raporti i oficerit me numër të rastit 2022-BD-808, i datës 29.08.2022, procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarës – dëshmitares B. Rr, me numër të rastit 2022-BD-808, i datës 29.08.2022, procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuares - dëshmitares L. Rr., me numër të rastit 2022-BD-808, i datës 29.08.2022, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit A. S. me numër të rastit 2022-BD-808, i datës 29.08.2022, raport mjekësor nga spitali Sh. Z., V. me nr. të protollit 10046, i datë 29.08.2022, informacion për të kaluarën kriminale nga Policia e Kosovës për të pandehurin A.S. si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin mbi pranimin e fajësisë e ka pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e thellë të shprehur, premtimin e dhënë gjykatës se asnjëherë nuk do të përsëriten më veprime të tilla, faktin se i pandehuri është prind i një fëmije që ka nevojë për kujdes prindëror, seancën gjyqësore i pandehuri e ka përcjell me vëmendje të theksuar, si dhe ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh se njëra nga të dëmtuarat është viktimë e ndjeshme, ka qenë shtatzënë në kohën kur e ka pësuar nga vepra penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që në këtë rast është shëndeti i viktimës së ndjeshme, shkalla e përgjegjësisë penale, e që në rastin konkret vepra është kryer me dashje si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës për veprën penale *Sulmi* nga neni 184 par.3, nën par.3.1 të KPRK-së, ka paraparë dënim me burgim deri tre (3) vite, ndërsa për veprën penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite. Duke marrë parasysh rrethanat e lartë cekura lehtësuese e bazuar edhe në qëllimin dhe kushtet e parapara lidhur me dënimin me kusht sipas neneve 51 dhe 52 të KPRK-së, gjykata të pandehurit dënimin me burgim ia ka kushtëzuar.

Gjykata në dënimin me burgim të kushtëzuar mori parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura lehtësuese e sidomos pranimin e fajësisë dhe pendimin e të pandehurit, se me të dëmtuarën B. Rr. kanë një fëmijë të posalindur dhe duhet përkujdesje e madhe nga të dy, gjendjen e dobët ekonomike, premtimin e dhënë gjykatës që nuk do të përsëris vepër penale, andaj gjykata vlerësoi se me pranimin e të gjitha këtyre rrethanave, e në vështrim të dispozitave të neneve 4, 7, 17, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 76, 184 par.3 nën par.3.1 dhe neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim më i lehtë apo më i rëndë, dhe edhe me këtë dënim me burgim me kusht ndaj të pandehurit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së, dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja

e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 450 dhe 453 të KPPK-së, vendimin mbi kërkesën pasurore juridike duke marrë parasysh provat në shkresat e lëndës dhe deklaratimet e të dëmtuarave dhe të pandehurit gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.2 të KPP-së, ndërsa, vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartë cekurat e bazuar në nenin 365 të KPPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.08/2023, datë: 16.02.2023

Procesmbajtësi - Praktikanti
Dardan Ibrahim

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.

Numri i lëndës: 2023:016337
Datë: 23.02.2023
Numri i dokumentit: 04009806